



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2020:179064

Datë: 16.02.2024

Numri i dokumentit: 05338286

C.nr. 5464/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditësve D. R dhe S. S, të dy nga Prishtina, të cilët sipas autorizimit përfaqësohen nga B. A avokat në Prishtinë, kundër të paditurit “D...” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, me objekt kontesti kompensimin e dëmit, vlera e objektit të kontestit 300.00 euro, me datë 08.02.2024 mbajti seancën gjyqësore në prezencën e të autorizuarit të paditësve, ndërsa me datë 16.02.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve D. R dhe S. S, ashtu që DETYROHET i paditurit “D...” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në automjetin e tipit V... gjatë bartjes së tij me datë 19.06.2020, në Prishtinë, t’ia kompensojë shumën prej 300.00 euro, me kamatë ligjore 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë (datë 17.12.2020), e deri në përmbushjen e tërësishme, si dhe ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 410.10 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykim, nën kërcënim të përmbartimit ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësit D. R dhe S. S nga Prishtina, nëpërmjet të autorizuarit të tyre, me datë 17.12.2020 në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, kanë parashtruar padi kundër të paditurit “D...” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, me objekt të padisë kompensimin e dëmit në vlerë prej 1,150.00 euro. Paditësit në padi, kanë theksuar se me datë 19.06.2020, në Prishtinë, i ishte shkaktuar dëm material në automjetin e tipit V..., me targa të regjistrimit.... Tutje ka theksuar se dëmi i automjetit është shkaktuar me fajin e shoferit të automjetit transportues (merimangës) K. B, i cili me rastin e konfiskimit të veturës së paditësve në mënyrë të pakujdesshme e ka dëmtuar automjetin në fjalë. Nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet në tërësi padia dhe të detyrohet i padituri që paditësit në emër të dëmit material, t’ia kompensojë shumën prej 1,150.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri “D...” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, në përgjigjen në padi e ka kontestuar bazën juridike të padisë, duke theksuar se sipas fletëparaqitjes të policisë, paditësit janë udhëzuar që të drejtën e tyre ta realizojë në kompaninë e Sigurimeve “K...”, e cila ka edhe mundësi që ia ka

kompensuar paditësve këtë dëm, por qe paditësit po e fshehin këtë fakt dhe po kërkojnë që ky dëm t'iu kompensohet dy herë. Po ashtu përveç bazës juridike i padituri e ka kundërshtuar edhe lartësinë e dëmit pasi që lartësia e kërkesës së paditësve fare nuk korrespondon me dëmin e pësuar në automjetin e tyre. Në fund nga gjykata ka kërkuar që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar padinë e paditësve.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 08.02.2024 në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur të ftuar me rregull.

Paditësit, përgjatë deklarimeve në seancat gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përmes përfaqësuesit sipas autorizimit të tyre, kanë qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë, të cilën e kanë precizuar me parashtrësën e datës 31.01.2024. Nga gjykata kanë kërkuar që të obligohet i padituri që paditësve t'ia kompensoj dëmin material të shkaktuar në veturë në shumë prej 300 euro më kamatë 8% nga dita e parashtrimit të padisë e deri në realizimin përfundimtar. Paditësit, po ashtu, kanë kërkuar shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumë prej 825.80 euro, për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, për përfaqësim në katër seanca shumë prej 540.80, për ekspertizën e makinerisë shumë prej 150 euro, si dhe 31.00 euro në emër të taksës gjyqësore për padi.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimeve të palës paditëse, ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat si në vijim: fletëparaqitja për kundërvajtje të datës 19.06.2020; policën e sigurimit me nr...; librezën e qarkullimit ....; procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit, të hartuar nga Kompania e Sigurimeve "K...", i datës 06.07.2020; fotografitë e realizuara nga Kompania e Sigurimeve "K..."; njoftimin e datës 13.07.2020, me numër 430/2020, të kompanisë së Sigurimeve "K..."; si dhe ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti gjyqësor Q. A, e datës 11.01.2024.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast, nuk është kontestues fakti se me datë 19.06.2020, në Prishtinë, gjatë bartjes së automjetit V..., pronë e paditëses S. S, përkatësisht me rastin e konfiskimit të saj, gjatë transportimit, vetura ishte dëmtuar dhe si pasojë e saj paditësve i është shkaktuar dëm material. Kontestues në mes ndërgjyqësve ishte fakti i përgjegjësisë së të paditurit në lidhje me dëmin material të shkaktuar.

Nga librezja e qarkullimit.... vërtetohet se vetura me këto tabela të regjistrimit, është pronë e paditëses S. S ndërsa paditësi D. R, sipas aktit noterial ka pasur autorizim gjeneral për shitjen dhe kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me automjetin në fjalë.

Me fletëparaqitjen për kundërvajtje numër....vërtetohet se me datën 19.06.2020, në Prishtinë, i padituri sipas urdhëresës së policisë, derisa po e transportonte veturën e konfiskuar të paditësve të tipit "V.", me tabela të regjistrimit ..., i ka shkaktuar dëme material – gërvishtje të vogla në anën e djathtë të pjesës së përparme veturës së paditëses S. S, ndërsa pala e dëmtuar D. S udhëzohet që me kopjen e këtij dokumenti të paraqitet në Kompaninë e Sigurimeve.

Nga polica e sigurimit me numër 0007352210, gjykata gjeti se vetura e paditësve ka pasur polisë siguruese valide dhe atë nga data 21.02.2020 deri me datë 21.02.2021, periudhë që përfshinë kohën në të cilën është shkaktuar dëmi.

Nga procesverbali mbi dëmtimin e automjetit, i datës 06.07.2020, gjykata gjeti se Kompania e Sigurimeve “K...” kishte bërë një evidentim të dëmeve të shkaktuar në automjet, ndërsa këto dëme ishin evidentuar edhe me fotografi.

Nga njoftimi me numër 430/2020, i lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “K...”, gjykata gjeti se paditësve iu ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e dëmit si e pabazuar, me arsyetimin se dëmi nuk është shkaktuar si pasojë e aksidentit në trafik apo rënies së gjësendeve nga mjeti motorik, por si pasojë e pakujdesisë së punonjësve në ngarkimin e automjetit, dhe se përgjegjës për kompensimin e këtij dëmi është kompania e “marimangës”.

Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha provave të administruara, të theksuara me lartë, erdhi në përfundim se me datë 19.06.2020, në Prishtinë, i padituri për shkak të parkimit të parregullt të mjetit transportues, i ka shkaktuar dëme materiale paditësit në veturën e tij, përkatësisht gërvishtje në anën e majtë të pjesës së përparme dhe të pasme, dëme këto që sipas ekspertizës së ekspertit të makinerisë Q. A, vlerësohen në shumë prej 300.00 euro, shumë të cilën i padituri është obliguar t’ia paguajë paditësve për kompensimin e këtij dëmi.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që aprovoi në tërësi të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke marrë për bazë nenin 136 par. 1, të LMD-së, ku përcaktohet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa fakti i shkaktimit të dëmit nuk u kontestuar as nga i padituri në përgjigjen në padi.

Përgjatë procedurës gjyqësore, u argumentua se i padituri mbahet përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe është i obliguar për kompensimin e këtij dëmi. Së këndejmi, mbi bazën e të gjitha provave të administruara në këtë procedurë, gjendjes faktike të vërtetuar, në pajtim me nenin 8 të LPK-së, përfundimisht gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e caktoi sipas ekspertizës së ekspertit të makinerisë Q. A të datës 11.01.2024, i cili ka konstatuar vlera e përgjithshme për riparimin e automjetit në fjalë, në kohën e ndodhjes së aksidentit, ishte 300.00 euro.

Gjykata e vlerësoi edhe pretendimin e të paditurit të ngritura në përgjigjen në padi lidhur me përgjegjësinë e kompanisë së sigurimeve për kompensimin e dëmit, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë nuk është i bazuar, kjo për faktin se paditësit i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e dëmit nga kompania në fjalë. Deri te ky përfundim, gjykata erdhi edhe duke marrë për bazë nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, në të cilin është përcaktuar se sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon: *“1.1 dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik”*, si dhe *“1.2 dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik, përfshinë gjithashtu dëmin e shkaktuar palëve të treta përmes gjësendeve të cilat bien nga mjetet motorike apo çdo gjë tjetër që është i lidhur me mjetin motorik”*, ndërsa në paragrafin 2 është përcaktuar se *“Ky sigurim nuk mbulon dëmet në sende të*

*cilat transportohen, përveç nëse ato shërbejnë për përdorim personal të pasagjerëve*". Meqenëse dëmi nuk ka ardhur nga përdorimi-vënja në lëvizje e automjetit të paditësve, por nga transportimi i këtij mjete nga ana e të paditurit, gjykata këtë pretendim e refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e ngritur përmes përgjigjes në padi të të paditurit se ka mundësi që paditësve i është kompensuar ky dëm nga kompania e sigurimeve, dhe se paditësit po e fshehin këtë fakt dhe po kërkojnë që ky dëm t'iu kompensohet dy herë, por gjeti se as ky pretendim nuk qëndron. Këtë vlerësim gjykata e mbështetë në nenin 322 paragrafi 3 të LPK-së që ka përcaktuar se *"Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër"*, por edhe duke marrë për bazë faktin se i padituri përkundër ftesave të rregullta për pjesëmarrje në seanca gjyqësore, nuk ka prezantuar në seancë për të argumentuar para gjykatës një pretendim të tillë.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit *"Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën"*. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar se *"Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë"*, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë datë 17.12.2020.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 452 të LPK - së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumë prej 410.10 euro i referohet shpenzimeve si në vijim: 78.00 euro për përpilimin e padisë, 30.00 euro për taksë gjyqësore për padi; 101.40 euro për përfaqësim në një seancë nga avokati dhe 50,70 euro për një seancë të shtyrë në lartësi prej 50% të vlerës sipas TOAK-së; si dhe 150 euro për ekspertizë të makinerisë.

Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse shpenzimet e procedurës në bazë të Rregullores për Tarifat e Avokatëve përbëjnë shpërblimin për punën e avokatit, ndërsa në lidhje me përfaqësimin nga të autorizuarit që nuk janë avokat, pala paditëse kërkesën për kompensim të shpenzimeve të procedurës nuk e ka specifikuar konform nenit 463 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.5464/20 datë 16.02.2024

Gjyqtarja  
Qëndresa Beqiri Murati

*KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*